



Raport Monitorimi mbi Buxhetimin me Pjesëmarrje dhe Përfshirjen e Prespektivës
Gjinore në Programin Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetin e Bashkive.

Nëntor 2021

Raport Monitorimi mbi Buxhetimin me Pjesëmarrje dhe Përfshirjen e Prespektivës Gjimore në Programin Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetin e Bashkive.

Ky raport u hartua nga Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (Qendra A.L.T.R.I) në kuadër të projektit me temë:

“Rritja e performancës dhe transparencës buxhetore të bashkive nëpërmjet përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje” e cila është pjesë e projektit rajonal WeBER 2.0, që financohet nga Bashkimi Europian dhe zbatohet në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

Raporti i monitorimit është përgatitur nga Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) në kuadër të iniciativës me temë “Rritja e performancës dhe transparencës buxhetore të bashkive nëpërmjet përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje”, e cila është pjesë e projektit rajonal WeBER 2.0, që financohet nga Bashkimi Europian dhe zbatohet në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.” Opinione të shprehura në këtë material nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| 1. Hyrje..... | 4 |
| 2. Metodologjia..... | 6 |
| 3. Rezultatet e Monitorimit..... | 7 |
| 3.1 Analizë e të dhënave të mbledhura në bashkitë Lushnje, Krujë, Cërrik, Gramsh dhe Malësi e Madhe mbi zbatimin e konsultimeve publike me në fokus buxhetimin dhe Programin Buxhetor Afatmesëm..... | 7 |
| 3.2. Efektiviteti i pjesëmarrjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në buxhetimin me pjesëmarrje dhe PBA-në e bashkive dhe konsiderimi i rekomandimeve të tyre..... | 10 |
| 3.3 Analizë e buxhetimit gjinor me pjesëmarrje sipas të dhënave të mbledhura nga përfaqësuesit e bashkive të monitoruara dhe anketat me gratë e zonës..... | 13 |
| 3.3.1 Faktorët ndikues, masat e marra dhe perceptimi qytetar mbi buxhetimin gjinor me pjesëmarrje..... | 16 |
| 4 Përmbledhje e gjetjeve kryesore..... | 21 |
| 5 Rekomandime..... | 24 |

1. Hyrje

Buxhetimi me pjesëmarrje (BP) është një mekanizëm që lejon qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrje dhe synon që të sjellë komunitetet lokale sa më afër procesit të vendimmarrjes lidhur me buxhetin publik. Kjo praktikë e re financiare jo vetëm ndihmon qeverisjen vendore për të përmirësuar transparencën, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e saj në ushtrimin e kompetencave të ngarkuara me ligj, por është edhe një metodë e ushtrimit të demokracisë së drejtëpërdrejtë nga qytetarët. Buxhetimi me pjesëmarrje ka rezultuar gjithashtu, të jetë edhe metoda më e zakonshme e përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Një ndër përfitimet që i njihet BP-së është përfshirja sociale dhe fuqizimi i grupeve në nevojë, pasi duke përfshirë zërin e këtyre grupeve, shpenzimet dhe investimet mund të drejtohen drejt përmbushjes së nevojave të tyre.

Buxhetimi me pjesëmarrje ka një ndikim thelbësor edhe në rritjen e besimit të qytetarëve tek qeverisja vendore, pasi në këtë mënyrë qytetarët janë më të informuar mbi shpenzimet dhe investimet për vitin pasardhës nga bashkia, gjithashtu qytetarët kuptojnë edhe se sa bashkia i merr në konsideratë rekomandimet e tyre.

Një komponent i rëndësishëm i programit buxhetor afatmesëm (PBA) dhe buxhetit të bashkive është edhe buxhetimi gjinor si një detyrim ligjor që synon integrimin e perspektivës gjinore në këto dokumente. Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në nenin 2 pikën 8 të saj, thekson që ligji ka si qëllim të sigurojë që në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare vendore të njësive të vetëqeverisjes vendore, realizimin e barazisë gjinore. Ndër të tjera, në PBA vendore theksohet se të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore. Po ashtu edhe në leximin e dispozitave të monitorimit, raportimit, vlerësimit etj., kuptohet që

ligji ka krijuar mundësitë për përfshirjen e efektshme të Buxhetimit të Përgjithshëm Gjinnor (BPGJ) në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar vendor nga njësitë e qeverisjes vendore.

Përfshirja e organizatave lokale dhe grave në procesin e konsultimit të PBA-së dhe buxhetit është thelbësor për përcaktimin e politikave dhe financimeve në drejtim të respektimit të parimit të barazisë gjinore. Pavarësisht parashikimeve ligjore aktuale mbi këtë komponent (prespektiva gjinore), aplikimi i tij në praktikë vijon të mbetet problematik.

Përfshirja e barazisë gjinore është gjithashtu, një element i rëndësishëm i negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian ku kritika dhe rekomandime për një zbatim më të kënaqshëm dhe gjithëpërfshirës i këtij komponenti vërehen edhe në progres-raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së grave, përfaqësimit të tyre në politikë dhe qeverisje në të gjitha nivelet, nëpërmjet mbështetjes për demokracinë dhe programet e qeverisjes dhe reformat e administratës publike, parashikohet gjithashtu në Planin e III-të të Veprimit Gjinnor të BE-së.

Nëpërmjet këtij raporti do të informoheni mbi mënyrën e realizimit të buxhetimit me pjesëmarrje dhe përfshirjes së prespektivës gjinore në buxhetim dhe PBA-të në Bashkitë Cërrik, Gramsh, Lushnje, Krujë dhe Malësi e Madhe. Gjithashtu, raporti paraqet të dhëna statistikore dhe opinione qytetare të mbledhura gjatë zhvillimit të anketave me qytetaret gra pranë këtyre bashkive.

2. Metodologjia

Metodologjia e monitorimit është realizuar bazuar në qëllimin dhe objektivat e projektit të zbatuar nga Qendra ALTRI, me titull "Rritja e performancës dhe transparencën buxhetore të bashkive nëpërmjet përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje" e cila është pjesë e projektit rajonal WeBER 2.0, që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Bashkitë të cilat kanë qenë pjesë e monitorimit janë bashkitë Cërrik, Gramsh, Lushnje, Krujë dhe Malësi e Madhe.

Për realizimin e procesit të monitorimit dhe me qëllim mbledhjen e të dhënave është shfrytëzuar kombinimi i tre metodave kryesore, të cilat kanë konsistuar në:

- a) anketimin e qytetarëve gra që jetojnë në bashkitë e targetuara;
- b) intervistat me stafin e bashkive;
- c) konsultimi i dokumenteve të bashkisë mbi buxhetimin gjinor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm.

Në lidhje me anketat për gratë janë zhvilluar mbi 500 anketa në total, nga ku të paktën 100 në secilën bashki. Anketat janë zhvilluar nëpërmjet anketuesit me qëllim mbledhjen e të dhënave sa më të detajuara dhe lehtësimin e qytetarëve në plotësimin e pyetjeve të adresuara. Janë zhvilluar gjithashtu, 15 intervista me punonjës të bashkisë, të cilët janë përzgjedhur bazuar në pozicionin e tyre dhe fushën që mbulonin në këto bashki me qëllim që informacioni i dhënë prej tyre të ishte i plotë dhe brenda fushës së monitorimit. Në këtë mënyrë, pozicionet të cilat mbulonin stafi i të intervistuarve i përkasin kryesisht pozicionit të drejtorit, përgjegjësit dhe specialistit në drejtorinë e financës, koordinatorit të konsultimit publik, përgjegjësit për marrëdhënien me publikun, këshillëtarit të Këshillin Bashkiak etj. Ndër të tjera, për realizimin e monitorimit janë konsultuar dokumente të disponueshme online apo të vëna në dispozicion nga bashkitë mbi zhvillimin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe prespektivën gjinore, si dhe parashikimet ligjore aktuale sa i përket komponentëve të lartpërmendur (buxhetimi me pjesëmarrje dhe PBA-në).

3. Rezultatet e Monitorimit

3.1 Analizë e të dhënave të mbledhura në bashkitë Lushnje, Krujë, Cërrik, Gramsh dhe Malësi e Madhe mbi zbatimin e konsultimeve publike me në fokus buxhetimin dhe Programin Buxhetor Afatmesëm.

Referuar parashikimeve ligjore aktuale, organet e vetëqeverisjes vendore, si organe publike, kanë detyrimin të zhvillojnë konsultime publike me qytetarët në pothuajse të gjitha proceset vendimmarrëse që ata realizojnë. Konkretisht, ky detyrim pasqyrohet në ligjin Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", Ligji Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", Ligji Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit". Buxhetimi me pjesëmarrje dhe prespektiva gjinore në buxhetim dhe PBA janë gjithashtu komponentë të detyrueshëm ligjor për të cilat bashkitë duhet të zhvillojnë konsultim publik me qytetarët me qëllim orientimin e shpenzimeve dhe investimeve drejt nevojave të komunitetit të saj dhe për të siguruar përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse të bashkisë.

Për të kuptuar më qartë se si bashkitë e realizojnë buxhetimin me pjesëmarrje, janë mbledhur të dhëna nëpërmjet intervistave me stafin e bashkisë. Referuar pyetjes së parë të drejtuar stafit të bashkive, *sa i përket zbatimit faktik të konsultimit publik* në tërësi dhe veçanërisht zhvillimit të buxhetimit me pjesëmarrje, të intervistuarit u shprehën se janë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme konsultime publike dhe janë përdorur të gjitha mjetet e nevojshme për njoftimin e qytetarëve. Mënyra se si organizohet dhe zhvillohet buxhetimi me pjesëmarrje nga bashkitë rezultojnë të jetë e ngjashme për të gjitha bashkitë e monitoruara. Stafit të bashkive të intervistuar shprehen se *takimet për diskutimin e buxhetit realizohen në bashki dhe në secilën njësi administrative të tyre*. Shtrirja e konsultimeve të buxhetit në të gjitha njësitë administrative shihet me rëndësi dhe argumentohet nga të intervistuarit si e vetmja mënyrë që mund të sigurojë gjithëpërfshirje të komunitetit dhe mbulim të të gjitha fshatrave.

Sipas tyre, bashkia shkon pranë qytetarit duke lehtësuar dhe shmangur të gjitha pengesat e largësisë me qytetin apo të kostove të transportit për qytetarët.

Po ashtu, gjatë intervistimit konstatohet që secila nga bashkitë e monitoruara ka ngarkuar me detyrën e koordinatorit të konsultimit publik të paktën një punonjës të bashkisë (Malësia e Madhe ka dy koordinatorë aktualisht). Këto koordinatorë publik, sipas të intervistuarve, përveç realizimit të administrimit, organizimit dhe realizimit të njoftimeve për konsultimet publike, ndikojnë në nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve duke qenë më pranë tyre dhe duke referuar edhe problematikat që ata shprehin në drejtim të bashkisë.

Një aspekt shumë i rëndësishëm për të zhvilluar konsultime publike efektive dhe që sigurojnë pjesëmarrje të qytetarëve është edhe sigurimi i njoftimit të qytetarëve në një periudhë të mëparshme, duke i përcaktuar qartë të dhënat bazë, si vendin e mbajtjes së konsultimit publik, orën, temën e diskutimit, vënia në dispozicion e materialeve që do diskutohen, mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre etj.

Për mënyrën se si realizohet njoftimi i qytetarëve, punonjësit e intervistuar të **Bashkisë Cërrik** shprehen se është zgjedhur një mënyrë e veçantë njoftimi që realizohet nëpërmjet disa ftesave individuale, të cilat shpërndahen nga punonjësit e bashkisë apo të njësive administrative në banesat e qytetarëve. Sipas tyre *"kjo metodë synon gjithëpërfshirje me qëllim që çdo qytetar, edhe nga zonat e largëta (fshatra të thella) të informohet dhe të ftohet të marrin pjesë në konsultimin publik të buxhetit. Nuk mund të themi që kemi siguruar njoftim në nivel 100% por që pjesa më e madhe e qytetarëve janë njoftuar"*. Ndër të tjera, të intervistuarit shprehen se si metodë njoftimi është përdorur edhe *media sociale* dhe *media televizive*. Në **Bashkinë Lushnje**, punonjësit e intervistuar shprehen se *"njoftimet realizohen në faqen zyrtare web të bashkisë, nëpërmjet rrjeteve sociale në Facebook, por dhe nëpërmjet njoftimit që vetë njësitet administrative të bashkisë realizojnë me stafin e tyre."* **Bashkia Krujë**, sipas punonjësve të intervistuar, mundëson njoftimin e qytetarëve nëpërmjet *njoftimeve pranë zyrave të Bashkisë dhe njësive*

Administrative (për të qenë më afër qytetarit), si dhe në rrjetet sociale (facebook apo Instagram).

Në mënyrë të ngjashme edhe **Bashkia Malësi e Madhe** përdor afishimin në këndin e informimit të bashkisë kryesisht, faqen zyretare apo rrjetet sociale dhe median televizive. Po ashtu, edhe **Bashkia Gramsh** përdor pothuajse të njëjtën metodë informimi duke publikuar njoftimin në stemën e njoftimeve (ku vihen njoftimet e ngjarjeve të qytetit), nëpërmjet thirrjeve të publikuara në zyrat e bashkisë dhe në mediat sociale të bashkisë.

Nga zhvillimi i anketave për gratë e zonës në pesë bashkitë e monitoruara, sa i përket marrjes së njoftimit prej tyre apo që kanë patur dijeni për zhvillimin e konsultimeve publike, rezulton se nga 100 qytetare të intervistuar në secilën, mbi 50 % e tyre shprehen se janë njoftuar/kanë patur dijeni për zhvillimin e konsultimeve publike pranë bashkisë së tyre, por gjithashtu rezulton se *vetëm një numër i vogël i tyre kanë marrë pjesë në këto takime* (trajtuar në vijim të këtij raporti, pjesa 3.3). Konkretisht, në Bashkinë Malësi e Madhe rezultojnë se janë njoftuar/kanë patur dijeni 63.8 % e qytetareve të intervistuar, në Bashkinë Cërrik rezultojnë 61%, në Bashkinë Krujë 56%, ndërkohë që në Bashkinë Lushnje edhe Gramsh rezulton një përqindje thujse e njëjlojtë me 52.6% për Lushnjen dhe 52.8% për Gramshin. Marrjen e informacionit për zhvillimin e konsultimeve publike në bashkitë e tyre, qytetarët shprehen se e kanë marrë kryesisht nëpërmjet internetit dhe televizorit, por gjithashtu edhe nëpërmjet njoftimeve të shpallura në zyrat e bashkisë apo në diskutimet me miqtë dhe të afërmit.

Për vitin 2020, konkludohet se gjatë këtij viti, bashkitë e monitoruara kanë realizuar procesin e buxhetimit me pjesëmarrje qytetare në numër të kufizuar deri në dhjetë pjesëmarrës, për shkak të kufizimeve të pandemisë Covid 19. Theksojmë që në Mars të vitit 2020 autoritetet shtetërore përcaktuan një sërë masash kufizuese, të cilat kishin për qëllim frenimin e shpërndarjes së infektiveve të pandemisë Covid 19. Këto masa prekën edhe institucionet dhe administratën publike në Shqipëri, të cilat duhet të punonin me staf të reduktuar, të realizonin mbledhjet dhe takimet nëpërmjet platformave elektronike dhe në rastet kur do të zhvilloheshin takime fizike, numri i personave prezent nuk duhet të ishte më shumë se dhjetë persona. Po ashtu, nga

intervista me stafin e bashkive, rezulton se përdorimi i platformave elektronike për zhvillimin e buxhetimit me pjesëmarrje në këto bashki është parë si i pamundur pasi, bashkitë e targetuara janë bashki të vogla dhe nuk kanë kapacitetet e duhura për ta mundësuar një konsultim efektiv nëpërmjet këtyre platformave. Të intervistuarit shprehen se në këto bashki, në pjesën më të madhe të zonave që ato mbulojnë, mungon infrastruktura e nevojshme për sigurimin e shpërndarjes së rrjetit të internetit. Gjithashtu, sipas tyre gjendemi përballë pamundësisë reale të aksesit të qytetarëve dhe të informimit të tyre për të përdorur platforma të tilla, pasi një pjesë e qytetarëve nuk kanë aparatë celularë apo kompjutera, nuk kanë internet apo nuk kanë njohuritë dhe aftësitë e duhura për t'i përdorur ato.

Në pyetjen drejtuar bashkisë mbi krijimin e një mekanizmi tjetër alternativ, nëpërmjet të cilës qytetarët të mund të adresonin problematikat apo sugjerimet e tyre lidhur me buxhetimin e vitit pasardhës apo PBA-në gjatë kësaj periudhe, stafi i bashkive është shprehur se nuk ka patur një mekanizëm të veçantë për këtë qëllim, por qytetarët kanë në dispozicion të tyre disa mënyra të përgjithshme se si mund të adresojnë problematika dhe sugjerime, të cilat janë shkresat zyrtare drejtuar bashkisë, përdorimi i hapsirave të kontakteve nëpërmjet faqes web të bashkisë apo komunikimi me zyrat e bashkisë. Pavarësisht ekzistencës së këtyre metodave të referimit të sugjerimeve dhe problematikave, qytetarët nuk janë shumë të informuar dhe të familjarizuar me përdorimin e dy metodave të parave, pra me dërgimin e shkresave dhe përdorimin e faqes web. Ndërkohë, referimi i problematikave pranë zyrave të bashkisë është metoda më e përdorur prej qytetarëve.

3.2. Efektiviteti i pjesëmarrjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në buxhetimin me pjesëmarrje dhe PBA-në e bashkive dhe konsiderimi i rekomandimeve të tyre.

Në lidhje me efektivitetin që ka patur pjesëmarrja qytetare në zhvillimin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsiderimit të rekomandimeve të tyre nga ana e bashkive, të intervistuarit

shprehen se qytetarët jo vetëm që kanë marrë pjesë në këto takime, por edhe kanë qenë aktiv në diskutime duke shprehur mendimin e tyre dhe duke paraqitur problematikat e zonës nga ata vinin. Të pesta bashkitë e monitoruara shprehen se rekomandimet janë marrë parasysh në varësi të mundësive financiare të disponueshme nga bashkia, duke mbajtur në konsideratë fillimisht prioritetet e bashkisë.

Punonjësit e intervistuar nga **Bashkia Cërrik** theksojnë se *"rekomandimet e qytetarëve patjetër që merren parasysh pasi, nëpërmjet konsultimeve bashkia orienton shërbimet dhe investimet atje ku kërkohet më shumë. Problemet që prezantohen janë shumë të mëdha por vëmendjen imediate e kushtojmë tek ato raste që kërkojnë një ndërhyrje urgjente apo prioritetet. Disa investime kërkojnë jo vetëm financim por edhe kohë për t'u realizuar siç duhet."* Të njëjtin qëndrim mbajnë edhe të intervistuarit nga **Bashkia Krujë**, të cilët theksojnë që buxheti hartohet duke mbajtur parasysh çështjet prioritare si Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm, kujdesi social ndaj personave me nevoja të veçanta dhe ujitja e kullimi (duke qenë se bujqësia përbën një fushë që zë një pjesë të konsiderueshme të zhvillimit ekonomik të zonës së Krujës). Ndërkohë, të intervistuarit nga **Bashkia Gramsh** shprehen se rekomandimet e qytetarëve janë marrë parasysh në masën 65%. **Bashkia Lushnje**, sipas punonjësve të saj, jo vetëm ka marrë parasysh rekomandimet e qytetarëve por një pjesë e tyre janë reflektuar në PBA-në e hartuar nga bashkia. Sipas tyre, *"grupi i menaxhimit strategjik shqyrtoi dhe analizoi rekomandimet e paraqitura nga qytetarët dhe të adresuara tek Bashkia Lushnjë përmes sondazhit online në lidhje me çështjet prioritare që qytetarët kanë përzgjedhur nëpërmjet konsultimit online. Nëpërmjet të dhënave të sondazhit, kërkohet që të rriten fondet për rrjetin rrugor, për shërbimin e pastrimit, për ndriçim publik dhe për aktivitetet që nxisin punësimin. Këto rekomandime kanë gjetur zbatim dhe pothuajse janë të realizuara në këtë fazë të PBA-së."* Edhe në **Bashkinë Malësi e Madhe**, rekomandimet e adresuara të qytetarëve merren parasysh, por sipas të intervistuarve, ka edhe problematika të cilat nuk mund të realizohen për shkak të numrit të ulët të qytetarëve që i kërkojnë dhe pamjaftueshmërisë së kapaciteteve buxhetore të bashkisë për t'i realizuar ato.

Rezulton se në PBA-të e bashkive të targetuara, rekomandimet merren parasysh pasi PBA është një dokument strategjik 3 vjeçar, kurse në buxhetin vjetor shikohet si më problematike reagimi dhe parashikimi i rekomandimeve pasi, buxheti i kufizuar për pushtetin vendor bën që rekomandimet e qytetarëve të kategorizohen në ato që janë prioritare dhe më pak prioritare. Sipas stafit të bashkisë, kjo ndodh pasi bashkia kryen shumë shërbime me pak buxhet dhe mundësitë financiare të bashkive nuk janë aq të mëdha sa të mbulojë çdo kërkesë Brenda vitit.

Sa i përket mendimit që kanë qytetaret gra të intervistuar nëpërmjet anketave (pyetësorëve) në këto bashki mbi marrjen dhe konsiderimin e rekomandimeve të tyre nga bashkia, rezulton se:

- për pjesën më të madhe të tyre rekomandimet merren parasyshë *ndonjëherë* (kanë zgjedhur alternativën "*ndonjëherë*" 64.8 % të qytetareve nga Malësia e Madhe, 54 % nga Bashkia Cërrik, 51% nga Bashkia Krujë, 48.6% nga Bashkia Gramsh dhe 33.7 nga Bashkia Lushnje).
- pjesa që kanë zgjedhur alternativën *Po, merren parasysh* janë **32.7 % qytetare gra nga Bashkia Lushnje**, prej të cilave theksohet se janë marrë në konsideratë rekomandimet për rregullimin e një shkolle, ngritjen e një çerdhje të re, pastrimin e qytetit apo investimi në rrugë. **21% të qytetareve nga Bashkia Cërrik** mendojnë që rekomandimet merren parasysh duke referuar si rekomandime të konsideruara ndërtimin e parkut të lojrave në njësinë Mollas, rikonstrukcionin e rrugës në njësinë Licaj, riparimin e një shkolle filllore, investimi në bujqësi, kanalizime, pastrimin e qytetit dhe koshave të plehrave. Nga **Bashkia Gramsh, 19.4 %** e qytetareve që mbajnë qëndrimin se rekomandimet e tyre merren në konsideratë, janë u shprehur se rekomandimet dhe kërkesat, të cilat janë referuar nga një shumicë qytetarësh dhe që janë kërkuar me ngulm të realizohen, kanë nxitur bashkinë që t'i realizojë ato. Disa të tjerë shprehen se edhe qytetarët duhet të jenë të vetëdijshëm për kapacitetet e bashkisë dhe mundësitë që ka ajo për të realizuar kërkesat e komunitetit dhe të kërkojnë ato investime që janë të mundshme të

realizohen. **Bashkia Krujë** rezulton me një numër më të vogël qytetarësh që mendojnë se rekomandimet e tyre merren në konsideratë nga kjo bashki. Vetëm **12%** e 100 të anketuarve në këtë zone janë shprehur me përgjigjiën "*Po, merren parasysh*". Po ashtu edhe në këtë bashki, nuk shprehen në mënyrë konkrete për një rekomandim të tyrin apo të familjarëve/miqve që është marrë në konsideratë dhe është realizuar, por në terma të përgjithshme shprehen se qytetarët duhet të jenë më këmbëngulës dhe të bashkohen me njëri-tjetrin kur kanë problematika të njëjta për të adresuar sepse vetëm kështu mund të ndërmerren masa bashkia, pasi ajo është në shërbim të qytetarëve të saj, por nuk ka vullnet nga qytetarët për të reaguuar. **Në Bashkinë Malësi e Madhe, 21.9%** pretendojnë që rekomandimet e tyre konsiderohen, por asnjë rast konkret i rekomandimeve të kërkuara që është realizuar nga bashkia nuk u referuan nga këta qytetarë.

- Një numër qytetarësh nga të intervistuarit kanë zgjedhur "*Jo, nuk merren parasysh*", nga ku rezultojnë 27.9 % në Bashkinë Lushnje, 25 % në Bashkinë Cërrik dhe Krujë, 18.1% në Bashkinë Gramsh dhe 13.3% në Bashkinë Malësi e Madhe.
- Një numër i vogël i qytetarëve shprehen se **nuk e dinë** nëse këto rekomandime merren parasysh pasi nuk kanë adresuar një të tillë përpara bashkisë.


3.3 Analizë e buxhetimit gjinor me pjesëmarrje sipas të dhënave të mbledhura nga përfaqësuesit e bashkive të monitoruara dhe anketat me gratë e zonës.

Nga të intervistuarit e pesë bashkive të monitoruara dakortësohet se në takimet e realizuara për buxhetimin, pjesëmarrja është mbizotëruar nga gjinia mashkullore. Sipas përgjigjive të të intervistuarve, raporti i pjesëmarrjes në **Bashkinë Cërrik** varion nga 65%- 70% pjesëmarrje burra me 35-30% gra, për **Bashkinë Krujë** raporti është 73% meshkuj me 27% femra, ndërkohë që në **Malësinë e Madhe** raporti varion deri në 30%. Për bashkinë **Lushnje dhe Krujë** nuk ka një

përcaktim statistikor me përqindje por sipas të intervistuarve vlerat janë të përafërta me ato të cituara më sipër duke shprehur qartë që pjesëmarrja më e madhe mbulohet nga gjinia mashkullore. Po ashtu, të intervistuarit shprehen se së fundmi është vënë re një rritje e pjesëmarrjes së grave në krahasim me vitet e mëparshme duke nxitur kështu edhe qytetare të tjera gra që të marrin pjesë dhe të adresojnë rekomandimet e tyre në këto takime. Disa shprehen se kjo rritje e pjesëmarrjes së grave vjen si shkak i emigrimit të bashkëshortëve burra në këto bashki, ndërsa disa të tjerë theksojnë që gratë kanë rritur ndërgjegjësimin e tyre dhe janë më të informuara se më parë.


Edhe nga të dhënat e mbledhura nëpërmjet anketave për gratë në secilën bashki rezultatet tregojnë një *pjesëmarrje shumë të vogël të grave* në takimet konsultuese të buxhetit apo PBA-së. Pjesa më e madhe e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë marrë pjesë asnjëherë ose kanë marrë pjesë vetëm një herë në këto takime dhe një numër shumë i vogël është shprehur që kanë marrë pjesë disa herë.

Konkretisht, në **Bashkinë Malësi e Madhe**, siç rezulton edhe nga grafiku i mëposhtëm 74.3 % e të anketuarave nuk kanë marrë pjesë asnjëherë, 21.9% kanë marrë pjesë vetëm një herë, ndërkohë që vetëm 3% shprehen se kanë marrë pjesë disa herë.



Grafiku 1: A keni marrë pjesë ndonjëherë në konsultimin publik mbi buxhetimin të realizuar nga bashkia e zonës suaj (Malësi e Madhe)?


Thuajse në të njëjtën situatë paraqitet edhe niveli i pjesëmarrjes së grave të **Bashkisë Krujë**, ku nga anketat e zhvilluara në këtë qytet rezultojnë që 79% e grave nuk kanë marrë pjesë asnjëherë, 17 % kanë marrë pjesë vetëm 1 herë dhe 3% kanë marrë pjesë disa herë.



- Po, kam marrë pjesë 1 herë
- Po, disa herë
- Jo, asnjëherë
- nuk kam patur dijeni

Grafiku 2: A keni marrë pjesë ndonjëherë në konsultimin publik mbi buxhetimin të realizuar nga bashkia e zonës suaj (Krujë)?


Në Bashkinë Gramsh rezultojnë që 76.4% e grave të anketuar që nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në buxhetimin me pjesëmarrje dhe PBA-në e bashkisë, 13.9% kanë marrë pjesë vetëm 1 herë dhe 9.7% kanë marrë pjesë disa herë.



- Po, kam marrë pjesë 1 herë
- Po, disa herë
- Jo, asnjëherë

Grafiku 3: A keni marrë pjesë ndonjëherë në konsultimin publik mbi buxhetimin të realizuar nga bashkia e zonës suaj (Gramsh)?


Në krahasim me bashkitë e sipërpërmendura, pjesëmarrja e grave në Bashkinë Lushnje dhe Cërrik duket më e favorshme, pavarësisht se niveli i mospjesëmarrjes është sërish i lartë. Në Bashkinë Lushnje, 50.9% e të anketuarave nuk kanë marrë pjesë asnjëherë, 23.1% kanë marrë pjesë vetëm 1 herë dhe 26% kanë marrë pjesë disa herë.



- Po, kam marrë pjesë 1 herë
- Po, disa herë
- Jo, asnjëherë
- nuk kam patur dijeni
- Nuk ka pasur dijeni
- nuk kam patur dijeni per zhvillimin e konsultimit
- Nuk kam patur dijeni, i bejne te gjitha...
- nuk kam interes
- Nuk kam kohe

Grafiku 4: A keni marrë pjesë ndonjëherë në konsultimin publik mbi buxhetimin të realizuar nga bashkia e zonës suaj (Lushnje)?

Së fundmi, në **Bashkinë Cërrik** rezultojnë që 50% nuk kanë marrë pjesë asnjëherë, 30% kanë marrë pjesë vetëm 1 herë dhe 20% kanë marrë pjesë disa herë.



Grafiku 4: A keni marrë pjesë ndonjëherë në konsultimin publik mbi buxhetimin të realizuar nga bashkia e zonës suaj (Cërrik)?

Nga sa më lart, rezulton se zhvillimin efektiv i buxhetimit gjinor me pjesëmarrje është në një nivel jo të kënaqshëm dhe ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm. Kjo konstatohet jo vetëm në aspektet e barazisë gjinore në pjesëmarrje të tyre në takimet konsultuese, por edhe në nivelin e përfitimeve nga parashikimet dhe orientimet e zërave buxhetor dhe investimeve, pasi bashkitë deri në këtë moment nuk kanë një databazë nga e cila të mund të parashikojë nivelin e përfitimeve për burrat dhe gratë për programe të ndryshme buxhetore.

3.3.1 Faktorët ndikues, masat e marra dhe perceptimi qytetar mbi buxhetimin gjinor me pjesëmarrje.

Nisur nga të dhënat e mësipërme të mbledhura dhe të dëshmuara nga stafi i intervistuar i bashkive dhe grave të anketuara në këto bashki, ku raporti i pjesëmarrjes së burrave dhe grave në buxhetimin me pjesëmarrje peshon në favor të burrave, nevoja lindi për të kuptuar se cilët janë **faktorët që ndikojnë** në mospërfshirjen e grave në proceset konsultuese të buxhetit dhe PBA-së së bashkisë. Më poshtë kemi renditur faktorët, të cilat sipas të intervistuarve nga 5 bashkitë e monitoruara (stafi i bashkisë dhe gratë), konsiderohen se ndikojnë në mospërfshirjen e grave në këto procese, duke i renditur ato nga faktori kryesor ose që ndikon më së shumti deri tek ai që ndikon më pak, si vijon:

1. Mungesa e kohës për shkak të detyrimeve familjare, përkujdesit për fëmijët dhe familjen apo të angazhimeve në punë;
2. Niveli i ulët i besimit të qytetarëve në institucionet shtetërore në tërësi dhe si rrjedhojë edhe për bashki;
3. Frika se do të paragjykoen nga shoqëria dhe gratë e tjera të zonës, pasi shumë qytetarë mendojnë se pjesëmarrja në takime publike dhe konsultime është një detyrë dhe rol që ju takon burrave;
4. Mosinteresimi, mungesa e dëshirës dhe indiferenca për të marrë pjesë dhe për të ndërhyrë apo rekomanduar në përcaktimin e politikave buxhetore të bashkisë;
5. Mungesa e informimit dhe ndërgjegjësimit të grave nga bashkia dhe organizatat e shoqërisë civile;
6. Mosnjoftimi dhe krijimi i lehtësirave nga bashkia;

Bazuar edhe në ligjin për konsultimin publik, bashkitë duhet të ndërmarrin të gjitha masat në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik.¹ Gjithashtu, në shtojcën nr.4 të **udhëzimit nr. 23, datë 30.7.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"** parashikon se BPGJ-ja është një mjet që siguron arritjen e barazisë gjinore nëpërmjet përfshirjes së një perspektive gjinore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për të promovuar barazinë gjinore.

Në pyetjen e drejtuar stafit të bashkive të intervistuar lidhur me zhvillimin e buxhetimit me pjesëmarrje, masat të cilat theksohen se janë marrë për përfshirjen e qytetarëve gra fokusohen kryesisht në:

¹ Neni 6, paragrafi 1 i ligjit Nr. 146/2014 'Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik'. I disponueshëm në: https://mb.gov.al/ep-content/uploads/2018/02/Ligji_per_Njoftimin_dhe_Konsultimin_Publik-1.pdf

- zhvillimin e njoftimeve për qytetarët në një periudhë kohore paraprake;
- publikimin në faqet zyrtare të këtyre bashkive të projektakteve të cilat do të diskutohen dhe konsultohen nëpërmjet zhvillimit të konsultimit publik;
- mbajtja dhe zhvillimi i proceseve konsultuese në çdo njësi administrative për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në këto takime (veçanërisht të qytetarëve nga zonat e thella);
- zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese për komunitetin (kryesisht të realizuara në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile).
- zhvillimin e sondazheve elektronike për komunitetin (Bashkitë Krujë, Cërrik dhe Lushnje). Nga stafi i **Bashkisë Krujë** theksohet se *"së fundmi Këshilli Bashkiak Krujë ka realizuar një sondazh për të kuptuar prioritetet e komunitetit të Bashkisë Krujë me qëllim për t'i vënë në funksion të hartimit të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe hartimit të buxhetit të vitit 2022. Ky sondazh evidentoi tre prioritetet kryesore, të cilat komuniteti i Bashkisë Krujë kërkon të konsiderohen si: a) Kujdesi për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara; b) ujitja dhe kullimi, si dhe c) arsimi i mesëm i përgjithshëm. Rezultatet e këtij sondazhi do të konsiderohen në hartimin e kërkesave buxhetore për vitet e ardhshme duke treguar edhe efektivitetin e këtij mekanizmi të përfshirjes së komunitetit në proceset vendimarrëse."*

Nga sa më sipër, rezulton se bashkitë janë përqëndruar në ndërmarrjen e masave me karakter tërësor, pra për të gjithë qytetarët dhe jo me fokus të veçantë gratë. Pavarësisht kësaj, konstatohet që edhe masat e ndërmarra janë kryesisht zbatim i detyrimeve ligjore të ligjit për konsultimin publik. Vërehet se është e nevojshme që bashkitë të angazhohen më shumë dhe në mënyrë të veçantë në informimin dhe ndërgjegjësimin e grave të zonës, me qëllim jo vetëm nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në këto takime, por edhe për të thyer barrierat shoqërore që ndikojnë në angazhimin e qytetarëve gra dhe krijimin e lehtësirave që nevojiten për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre.

Nga të dhënat e mbledhura nga anketat për gratë e zonës në bashkitë e targetuara, vërehet se ata i japin një rëndësi të konsiderueshme pjesëmarrjes së tyre në buxhetimin me pjesëmarrje, duke e vlerësuar si **të domosdoshme dhe të nevojshme** këtë pjesëmarrje nga gjinia femërore dhe vetëm një numër shumë i vogël mendojnë se është e panevojshme pjesëmarrja tyre (e grave). Konkretisht, në **Bashkinë Krujë** 54% e grave në këtë zonë kanë zgjedhur alternativën “e domosdoshme”, 43% kanë zgjedhur “e nevojshme”, ndërkohë që vetëm 3% kanë zgjedhur alternativën “e panevojshme”. I njëjti qëndrim konstatohet edhe në **Bashkinë Gramsh** ku 55.6% e vlerësojnë si të domosdoshme, 43.1% e vlerësojnë të nevojshme dhe vetëm 1.4% e vlerëson si të panevojshme pjesëmarrjen e grave. Në **Bashkinë Lushnje** 41% e vlerësojnë si të domosdoshme pjesëmarrjen e tyre, 52.9% e vlerësojnë të nevojshme dhe 5.8 % e vlerësojnë të panevojshme. Rezultatet e anketimit në **Bashkinë Cërrik** mbi qëndrimin e qytetarëve për pjesëmarrjen e tyre në këto takime paraqiten shumë të ngjashme me Bashkinë Lushnje, ku 38% e të anketuarave kanë zgjedhur alternativën “e domosdoshme”, 57% kanë zgjedhur “e nevojshme”, ndërkohë që vetëm 5% kanë zgjedhur alternativën “e panevojshme”. Së fundmi qëndrimi i mbajtur në **Bashkinë Malësi e Madhe** rezulton me 37.1 % për qytetaret që e mendojnë si të domosdoshme, 61.9% e vlerësojnë të nevojshme dhe vetëm 1% e konsideron si të panevojshme këtë pjesëmarrje.

Me qëllim për të kuptuar më tej mendimin perceptimin e grave nga pesë bashkitë e monitoruara mbi aspektet pozitive që mendohet se sjell pjesëmarrja e tyre në këto takime, u është kërkuar nëpërmjet anketës që të shprehin dakortësinë e tyre mbi frazat e mëposhtme, duke zgjedhur një nga alternativat si: Aspak dakord; Pjesërisht dakord; Dakord ose Shumë dakord:

- a. Pjesëmarrja ndihmon në informimin e grave të zonës mbi çështjet e miradministrit të buxhetit të bashkisë, taksave të mbledhura, investimeve, etj.
- b. Pjesëmarrja ndihmon gratë e zonës të adresojnë problematikat, shqetësimet dhe nevojat e tyre duke nxitur barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje.

- c. Pjesëmarrja ndihmon gratë e zonës në marrjen e përfitimeve direkte nga parashikimet buxhetore që do të miratohen pas adresimit të nevojave.
- d. Pjesëmarrja e grave në proceset buxhetore nxit kërkesën e llogaridhënies, transparencës, përgjegjshëmrisë së organeve vendore.

Në dy frazat e para (a dhe b) konstatohet një qëndrim dakordësie më i madh nga qytetarët ku një përqindje më e madhe i korespondon alternativës "dakord" dhe "shumë dakord", ndërkohë janë më të paktë gratë të cilat mbajën qëndrim "aspak dakord" ose "pjesërisht dakord". Ndërkohë që për dy frazat e tjera (c dhe d), pavarësisht se një pjesë e konsiderueshme kanë zgjedhur alternativën "dakord" dhe "shumë dakord", vërehet se përqindja e të dhënave tregon një rritje të qëndrimit të qytetareve që nuk janë dakord apo janë pjesërisht dakord me këtë frazë. Pra, nga këto të dhëna kuptohet që këto qytetare, të cilat përbëjnë rreth 30%-35% të të anketuarve, nuk mendojnë që pjesëmarrja e tyre do të sillte përfitime direkte nga parashikimet buxhetore pas adresimit të nevojave të tyre, duke lënë kështu të kuptohet se këta persona nuk mendojnë që kërkesat e tyre do të merren parasysh edhe nëse ata angazhohen me pjesëmarrjen e tyre në këto takime. Gjithashtu, kjo pjesë e qytetareve nuk mendojnë se pjesëmarrja e grave në proceset buxhetore do të nxisë kërkesën e llogaridhënies, transparencës apo përgjegjshëmrisë së organeve vendore.

Ndërkohë, në një hapsirë të veçantë të anketës u është kërkuar qytetarëve që të shprehin vërejtjet apo sugjerimet e tyre sa i përket buxhetimit gjinor. Nëpërmjet kësaj hapsire një pjesë e qytetarëve kërkojnë informim më të gjërë të qytetarëve, veçanërisht në zonat e thella dhe fshatra pasi sipas tyre, pjesëmarrja në vendimarrjen e bashkisë është e domosdoshme jo vetëm për të përmirësuar nivelin e barazisë gjinore në vend, por edhe për të krijuar një shoqëri aktive, e cila vetëpërfaqësohet dhe kërkon përmirësim të problematikave të shoqërisë. Gjithashtu, gratë e anketuara janë shprehur se pjesëmarrja e tyre është një komponent shumë i rëndësishëm për demokracinë dhe pa patur të drejta të barabarta nuk mund të pretendojmë as për demokraci apo për integrim në Evropë. Sipas tyre, gratë përballen me problematikat

më të mëdha të familjes, ndaj kërkojnë vëmendje më të madhe nga ana e bashkisë në nevojat e qytetareve gra, në punësimin e tyre dhe mbështetjen në rritjen dhe edukimin e fëmijëve.

4 Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Nga monitorimi i realizuar në Bashkitë Cërrik, Gramsh, Lushnje, Krujë dhe Malësi e Madhe, rezulton se për vitin 2020 bashkitë e monitoruara kanë zhvilluar konsultim me qytetarët për buxhetin e vitit pasardhës apo për Planin Buxhetor Afatmesëm me numër të kufizuar qytetarësh, deri në dhjetë persona, në respektimi të masave anti-Covid. Përdorimi i platformave online si metodë alternative për sigurimin e pjesëmarrjes në konsultimin publik me fokus buxhetin, konstatohet si i pamundur për t'u zhvilluar në këto bashki për shkak të mungesës së infrastrukturës së nevojshme për sigurimin e shpërndarjes së rrjetit të internetit, si dhe pamundësisë së aksesit të qytetarëve dhe të informimit të tyre për të përdorur platforma të tilla, pasi një pjesë e qytetarëve nuk kanë aparat celularë apo kompjutera, nuk kanë internet apo nuk kanë njohuritë dhe aftësitë e duhura për t'i përdorur ato.

Në tërësi, referuar viteve të mëparshme, vërehet që bashkitë i kanë zhvilluar konsultimet publike me qytetarët sa i përket buxhetimit dhe PBA-së duke u bazuar në parashikimet ligjore mbi mënyrën se si duhet të realizohen apo mbi procedurën e njoftimit të qytetarëve. Bashkitë kanë ngarkuar me detyrën e koordinatorit të posacëm për konsultimin publik një punonjës të bashkisë, i cili organizon dhe administron zhvillimin e konsultimeve publike. Gjithashtu, nga të intervistuarit në bashki vërehet se njoftimi i qytetarëve realizohet në disa forma që mundësojnë shpërndarjen e informacionit tek qytetarët, duke përdorur njoftimin në këndet e informimit të bashkive dhe rrjetet sociale më së tepërmi. Stafi i bashkive në tërësi shprehet se ka pjesëmarrje qytetare në këto takime por që kjo pjesëmarrje varion në numër qytetarësh nga zona se ku po realizohen. Në takimet konsultuese të zhvillura në qytet pjesëmarrja është më e madhe se në

fshatra dhe në njësitë administrative të këtyre fshatrave, pasi interesi dhe informimi i qytetarëve të qytetit është më i lartë se i qytetarëve në fshatra.

Në lidhje me rekomandimet dhe kërkesat e qytetarëve për parashikimet në buxhetimin e vitit pasardhës të bashkisë apo PBA-së, rezulton se bashkitë tentojnë të parashikojnë ato kërkesa të cilat janë në prioritetin e bashkisë dhe që janë të mundura të realizohen brenda kapaciteteve financiare të atij viti nga bashkia. Vërehet dhe pranohet nga stafi i bashkisë që janë një numër i konsideruar shërbimesh dhe kërkesash për kategori të ndryshme qytetarësh, të cilat për shkak të pamundësisë ekonomike dhe financiare të bashkisë janë të pamundura të realizohen dhe të përmbushen.

Rezulton se në PBA-të e bashkive të targetuara, rekomandimet merren parasysh pasi PBA është një dokument strategjik 3 vjeçar, kurse në buxhetin vjetor shikohet si më problematike reagimi dhe parashikimi i rekomandimeve pasi, buxheti i kufizuar për pushtetin vendor bën që rekomandimet e qytetarëve të kategorizohen në ato që janë prioritare dhe më pak prioritare. Sipas stafit të bashkisë, kjo ndodh pasi bashkia kryen shumë shërbime me pak buxhet dhe mundësitë financiare të bashkive nuk janë aq të mëdha sa të mbulojnë çdo kërkesë Brenda vitit.

Realizimi i prespektivës gjinore në buxhetim dhe PBA-të e bashkive të monitoruara konstatohet në një nivel jo të kënaqshëm. Kjo rezulton jo vetëm në aspektet e barazisë gjinore në pjesëmarrje të tyre në takimet konsultuese, por edhe në nivelin e përfitimeve nga parashikimet dhe orientimet e zërave buxhetorë dhe investimeve, pasi bashkitë deri në këtë moment nuk kanë një databazë nga e cila të mund të parashikojë nivelin e përfitimeve për burrat dhe gratë për programe të ndryshme buxhetore.

Në të pesta bashkitë e monitoruara vërehet një pjesëmarrje qytetare e mbizotëruar nga gjinia mashkullore. Pavarësisht se nga të dhënat e rezultuara nga anketat me gratë në këto bashki, rezulton se një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë marrë dijeni që është zhvilluar apo se do të zhvillohet konsultim publik me qytetarët, janë një numër shumë i vogël, rreth me pak se ¼

e grave të anketuara, që kanë marrë pjesë në këto takime. Faktorë që vërehen se pegojnë këtë pjesëmarrje janë kryesisht të lidhura me mungesën e kohës për shkak të angazhimeve të tyre, ndjenjës së paragjykimit nga shoqëria në të cilën jetojnë pasi për një masë të gjërë qytetarësh në këto bashki, pjesëmarrja në konsultime publike është një detyrë që u takon burrave dhe ata duhet të përfaqësojnë edhe zërin e grave të tyre.

Po ashtu, një element i cili konstatohet si i rëndësishëm dhe që ka zbehur edhe dëshirën e qytetarëve në tërësi për të marrë pjesë në konsultimet publike, është mungesa e lartë e besimit të qytetarëve në institucionet publike në tërësi, duke mos përjashtuar kështu as administratën vendore. Vërehet një qëndrim pasiv i qytetarëve për të marrë pjesë në këto takime duke u shprehur që pjesëmarrja e tyre nuk ndryshon asgjë pasi bashkia do të vendosë atë çfarë dëshiron dhe që nuk do të sjellë asnjë përfitim pjesëmarrja e tyre në këto takime.

Në masat e marra nga vetë bashkitë për nxitjen dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së grave në buxhetimin me pjesëmarrje, rezulton se këto masa janë kryesisht zbatim i drejtëpërdrejtë i detyrimeve ligjore të ligjit për konsultimin publik si; zhvillimi i njoftimeve në kohë të mëparshme, publikimi i materialeve etj., me përjashtim të fushatave ndërgjegjësuese të realizuara në bashkëpunim me organizatat. Konstatohet e nevojshme që bashkia të orientojë dhe të ndër marrë masa të posaçme për sigurimin e barazisë gjinore në këto takime.

5 Rekomandime

Në përfundim të raportit të monitorimit dhe evidentimin e gjetjeve dhe problematikave të cilat hasen në zhvillimin efektiv të bugjetimit me pjesëmarrje dhe prespektivës gjinore në buxhetim dhe Programin Buxhetor Afatmesëm të bashkive Cërrik, Gramsh, Lushnje, Krujë dhe Malësi e Madhe, propozohen rekomandimet e mëposhtme:

- Me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e saktë nga ana e bashkive të nivelit të përfitimeve për burrat dhe gratë për programe të ndryshme buxhetore rekomandohet krijimi i një *data base* të dhënash mbi përfituesit burra dhe gra në secilën bashki;
- Rekomandohet ndërmarrja e nismave të posaçme informuese dhe ndërgjegjësuese për të nxitur qytetarët në tërësi dhe në mënyrë të veçantë gratë, që të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse të buxhetimit dhe PBA-së.
- Rekomandohet ndërmarrja në mënyrë të vazhdueshme e fushatave informuese dhe promovuese mbi metodat dhe mekanizmat e adresimit të problematikave dhe rekomanimeve nga qytetarët, si dhe të përdorimit të faqes web nga qytetarët.
- Me qëllim gjithëpërfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse të bashkisë, rekomandohet mundësimi i një mekanizmi apo metode specifike që lehtëson dërgimin e rekomandimeve nga persona të cilët janë në pamundësi për të ndjekur dhe marrë pjesë në konsultimin publik të buxhetit;
- Duke marrë shkas nga periudha e pazakontë e krijuar si shkak i pandemisë, por referuar edhe zhvillimeve të larta teknologjike dhe metodave të demokracisë dixhitale të cilat mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje nëpërmjet platformave të ndryshme, rekomandohet përmirësimi i faqeve web dhe përshtatja e tyre me elementë

të cilët mundësojnë dërgimin e komenteve të ndryshme apo vlerësimin e akteve të cilat po shqyrtohen nga bashkia, siç mund të jetë buxhetimi apo PBA.

- Rekomandohet krijimi i një bashkëpunimi të ngushtë me median televizive lokale dhe përdorimi në mënyrë efektive i rrjeteve sociale të bashkive për të informuar dhe sensibilizuar qytetarët për buxhetimin me pjesëmarrje dhe rëndësinë e përfshirjes së tyre në këto takime;
- Rekomandohet zhvillimi i trajnimeve për stafin e bashkive mbi buxhetimin gjinor me qëllim reflektimin, analizimin apo vlerësimin e parashikimeve dhe arritjeve të buxhetit me bazë gjinore.
- Rekomandohet monitorimi i vazhdueshëm i shpenzimeve dhe shërbimeve, vlerësimi i shpërndarjes së buxheteve, si dhe vlerësimi i rezultateve (impaktit) të buxhetimit me bazë gjinore.